

Nr. _____ Prot.

Datë ____/____/2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

Datë: 15.04.2022

Drejtuar: Bashkimit të operatoreve ekonomik “Albstone” sh.p.k. me nr nipti: L33501202A, me adresë: fshati Balëz, pranë fabrikës së çimentos, Elbasan dhe operatorit ekonomik “Sori-Al” shpk me nr. nipti: K31510059D, me adresë: Rruga “Beqir Luga”, pallati nr. 3, sh. 1/1, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: “E hapur mbi kufirin monetar”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-14628-12-09-2021.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Shërbimi i pastrimit të ambjenteve të Albcontrol sha, me fond limit: 84,175,068 (tetëdhjetë e katër milion e njëqind e shtatëdhjetë e pese mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh, me afat 36 muaj.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të kësaj ju informojmë se ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “Alpen Pulito” sh.p.k. me nr nipti: K61516506H, me çmim të ofertës: 58,680,000 (pesëdhjetë e tetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh, adresa: lagjja nr. 14, Rruga Tirana, Shkozë, Durrës
2. Operatori Ekonomik “Alko-Implex General Construction” shpk me nr nipti: K91326028I, me çmim të ofertës: 59,844,210 (pesëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e dyzet e katër mijë e dyqind e dhjetë) lekë pa tvsh, adresa: rruga “Reshit Petrela” Tiranë.
3. Operatori Ekonomik “Clean Fast” sh.p.k. me nr nipti: L61807037R, me çmim të ofertës: 70,999,992 (shtatëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa tvsh, adresa: Bulevardi “Bajram Curri”, Godina ETC, Kati 13, Tiranë.
4. Operatori Ekonomik “Diol-Al” sh.p.k. me nr nipti: K67917301H, me çmim të ofertës: 74,952,650 (shtatëdhjetë e katërmilion e nëntëqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh, adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, kulla 2, kati 2, Tiranë.
5. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Albstone” sh.p.k. me nr nipti: L33501202A dhe operatorit ekonomik “Sori-Al” shpk me nr. nipti: K31510059D, me çmim të ofertës: 79,170,408 (shtatëdhjetë e

nëntë milion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e katër qind e tetë) lekë pa tvsh, adresa: fshati Balëz, pranë fabrikës së çimentos, Elbasan dhe rruga “Beqir Luga”, pallati nr. 3, sh. 1/1, Tiranë.

6. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k. me nr nipti: L61807037R dhe operatorit ekonomik “V.A.L.E. RECYCLING” shpk me nr. nipti: L28029301Q, me çmim të ofertës: 82,465,056 (tetëdhjetë e dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “Alpen Pulito” sh.p.k. me nr nipti: K61516506H, nuk i plotëson kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentat standarte të tenderit. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

a) Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilin parashikohet se ofertuesi duhet të paraqesë: *Operatorët ekonomikë për realizimin e kontratës duhet të ketë të punësuar jo me pak se 30 punonjës për tre muajt e fundit nga data e shpalljes së procedurës, për ndjekjen/zbatimin e kontratës.* Operatori ekonomik nuk e përmbushur këtë kriter për shkak se në listëpagesën e muajit nëntor OE ka deklaruar 23 punonjës.

b) Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilin parashikohet se ofertuesi duhet të paraqesë: *“Operatorët ekonomikë në lidhje me ceshtjet e sigurisë dhe shëndetit në punë duhet të ketë të punësuar me kontrate individuale të punës (një) mjek të shoqërisë.....”.* Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ka ngarkuar ne SPE “Kontratë Individuale Pune” të datës 03.10.2016 me mjekun e shoqërisë. Pamvarsisht kësaj kontrate, operatori ekonomik nuk e ka të deklaruar si pjesë të stafit të tij në listpagesat për 3 muajt e fundit.

c) Operatori ekonomik nuk plotëson shkronjën b, të pikës 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilin parashikohet se operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me Licencat/Lejet e mëposhtme: b) Grumbullim, transportimin, riciklimin, perpunimin dhe asgjësimi i mbetjeve urbane. Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ka ngarkuar ne SPE: Licence - Kodi III.2.B, me nr. Serial LN-2170-10-2016 me emërtim përshkrues të veprimtarisë: Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane. Pra objekti i licencës nuk përfshin proceset e tjera të kërkuara në DST atë të riciklimit, perpunimit dhe asgjësimit të mbetjeve.

2. Operatori Ekonomik “Alko-Implex General Construction” shpk me nr nipti: K91326028I, nuk i plotëson kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentat standarte të tenderit. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

Operatori ekonomik nuk plotëson shkronjën b, të pikës 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilin parashikohet se operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me Licencat/Lejet e mëposhtme: b) Grumbullim, transportimin, riciklimin, perpunimin dhe asgjësimi i mbetjeve urbane. Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ka ngarkuar ne SPE: Licence - Kodi III.2.B, me nr. Serial LN-1163-03-2016 me emërtim përshkrues të veprimtarisë: Transportim i mbetjeve jo të rrezikshme. Pra objekti i licencës nuk përfshin proceset e tjera të kërkuara në DST atë të grumbullimit, riciklimit, perpunimit dhe asgjësimit të mbetjeve.

3. Operatori Ekonomik “Clean Fast” sh.p.k. me nr nipti: L61807037R, nuk i plotëson kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentat standarte të tenderit. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

Operatori ekonomik nuk plotëson shkronjën b, të pikës 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilin parashikohet se operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me Licencat/Lejet e mëposhtme: b) *Grumbullim, transportimin, riciklimin, perpunimin dhe asgjësimi i mbetjeve urbane.*

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE: Licence - Kodi III.2.B, me nr. Serial LN-3708-08-2017 me emërtim përshkrues të veprimtarisë: Ngarkim, grumbullim, transportim dhe depozitim i mbetjeve urbane. Pra objekti i licencës nuk përfshin proceset e tjera të kërkuara në DST atë të *riciklimit, perpunimit dhe asgjësimit të mbetjeve.*

4. Operatori Ekonomik “Dion-Al” sh.p.k. me nr nipti: K67917301H, nuk i plotëson kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentat standarte të tenderit. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

Operatori ekonomik nuk plotëson shkronjën b, të pikës 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilin parashikohet se operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me Licencat/Lejet e mëposhtme: b) *Grumbullim, transportimin, riciklimin, perpunimin dhe asgjësimi i mbetjeve urbane.*

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE: Licence - Kodi III.2.B, me nr. Serial LN-0998-02-2016 me emërtim përshkrues të veprimtarisë: Grumbullim, transportim dhe depozitim i mbetjeve urbane. Pra objekti i licencës nuk përfshin proceset e tjera të kërkuara në DST atë të *riciklimit, perpunimit dhe asgjësimit të mbetjeve.*

5. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k. me nr nipti: L61807037R dhe operatorit ekonomik “V.a.l.e. Recycling” shpk me nr. nipti: L28029301Q, nuk i plotëson kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentat standarte të tenderit. Në këto kushte bazuar në nenin 92 të ligjit nr. 162/2020, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se oferta nuk është e vlefshme, bazuar në argumentat e mëposhtme:

Bashkimi i Operatoreve Ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në të cilin parashikohet se: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesë kontrata ku të kete realizuar shërbime të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël sa 40 % e fondit limit që prokurohet, të realizura gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Sipas kontrates së bashkëpunimit për bashkimin e operatoreve ekonomik, me nr. 344 Rep dhe nr. 91 Kol. datë 19.01.2022, pjesëmarrja në këtë procedurë është ndarë në raportet: 87.4 % për operatorin ekonomik “Pastrime Silvio” sh.p.k dhe 12.6 % për operatorin ekonomik “V.a.l.e. Recycling” shpk.

Në bazë të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nenit 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” pika 3 e tij specifikon se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Nga verifikimi I dokumentacionit të hedhur ne SPE rezulton se operatori ekonomik “V.a.l.e. Recycling” shpk, pjese e ketij bashkimi, nuk ka përmbushur pikën 2.3.1 për realizimin e shërbimeve të ngjashme me objekt shërbim pastrimi, në raport me përqindjen e marre persiper sipas kontrates se bashkëpunimit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatoreve ekonomik “Albstone” sh.p.k. me nr nipti: L33501202A, adresa: fshati Balez, pranë fabrikës së çimentos, Elbasan dhe operatorin ekonomik “Sori-Al” shpk me nr. nipti: K31510059D adresa: Rruga “Beqir Luga”, pallati nr. 3, sh. 1/1, Tiranë se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 79,170,408 (shtatëdhjetë e nentemilion e njëqind e shtatëdhjetë mijë e katër qind e tete) lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *shoqërisë “Albcontrol” sha* me adresë: Aeroporti “Nënë Tereza”, Rinas, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesat: Vendimi Përfundimtar me Nr. 208/5 prot. Datë 30.03.2022 me Nr. 294/2022 i Komisionit të Prokurimit Publik i cili ka vendosur:

Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Albstone” shpk & “Sori-AL” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-14628-12-09-2021, me objekt “Shërbimi i pastrimit të ambienteve të Albcontrol” Sh.A, me fond limit: 84,175,068 (tetëdhjetë e katër milion e njëqind e shtatëdhjetë e pese mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 19.01.2022, nga autoriteti kontraktor, “Albcontrol” sha (ish A.N.T.A).

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
HANTIN BONATI